



The Food Insecurity Experience Scale (FIES)

***Guidance for translation:
intended meanings of the questions and specific terms***

English
Spanish
Portuguese
French
Arabic
Russian
Chinese
Albanian

FAO, July 2015

Pyetjet përbërëse të modulit të Shkallës së Përvojës së Pasigurisë së Ushqimit dhe shpjegimi i kuptimeve të synuara.

“Tani dëshiroj t’ju bëj disa pyetje në lidhje me konsumin e ushqimit në 12 muajt e fundit”.

Gjatë 12 MUAJVE të fundit a ka ndodhur ndonjëherë që:

Q1. Keni qenë të shqetësuar se mund të mos ju mjaftonte ushqimi për shkak të mungesës së parave ose të burimeve të tjera?	Pyetja i referohet gjendjes së shqetësimit, ankthit, frikës, drojes ose merakut se mund të mos ketë ushqim të mjaftueshëm ose se ushqimi do të mbarojë sepse mungojnë paratë ose burimet e tjera për të siguruar ushqimin. Shqetësimi ose frika vjen prej rrethanave që e vështirësojnë mundësinë për të siguruar ushqim, të tilla si: humbja e vendit të punës ose e burimeve të tjera të të ardhurave, ose arsye të tjera të mos pasjes së parave të mjaftueshme; prodhimi i pamjaftueshëm i ushqimit për konsum vetjak; ushqim i pamjaftueshëm për t’u gjuajtur dhe për t’u vjelë; shkëputja e marrëdhënieve shoqërore; humbja e përfitimeve të rregullta/ndihmës ekonomike ose ndihmës me ushqime; krizat mjedisore ose politike. Nuk është e domosdoshme që për t’i kthyer përgjigjen PO kësaj pyetjeje i intervistuari të ketë patur në të vërtetë ushqim të pamjaftueshëm apo të ketë mbetur pa ushqim.
Q2. Nuk keni mundur të hani ushqime të shëndetshme dhe me vlera ushqyese për shkak të mungesës së parave ose burimeve të tjera?	Me anë të kësaj pyetjeje i intervistuari pyetet nëse ai/a jo nuk ka mundur të sigurojë ushqimet që ata i konsiderojnë të shëndetshme ose të mira, ushqime që i bëjnë të shëndetshme, ose ato që sigurojnë një dietë të ushqyeshme ose të ekuilibruar (sepse nuk ka patur paratë e mjaftueshme ose burime të tjera për ta siguruar ushqimin). Zëvendësime të mundshme: • Nuk keni mundur të hani ushqime që ju bëjnë mirë; • Nuk keni mundur të hani ushqime që i bëjnë mirë trupit tuaj; • Nuk keni mundur të hani ushqime të shëndetshme; • Nuk keni mundur të hani ushqime që sigurojnë një dietë të ushqyeshme ose të ekuilibruar. Përgjigja varet nga <u>mendimi i vetë të intervistuarit</u> në bazë të asaj që ai e konsideron ushqim të shëndetshëm dhe me vlera ushqyese. Kjo pyetje i referohet <u>cilësisë</u> së dietës dhe jo sasisë së ushqimit të konsumuar.
Q3. Keni ngrënë vetëm shumë pak ushqime të shumëllojshme/ të shëndetshme për shkak të mungesës së parave ose burimeve të tjera?	Me anë të kësaj pyetjeje i intervistuari pyetet nëse ai ka qenë i detyruar të mos hajë lloje të ndryshme ushqimesh, të hajë të njëjtat ushqime ose të hajë vetëm disa lloje çdo ditë sepse nuk ka patur paratë e mjaftueshme ose burime të tjera për të siguruar ushqimin. <i>Kjo pyetje nënkupton se shumëllojshmëria e ushqimeve të konsumuara do të rritej nëse familja kishte mundësi më të mira për të siguruar ushqimin.</i> Zëvendësime të mundshme: • <u>Ishit i detyruar</u> të hanit çdo ditë të njëjtin ushqim ose shumë pak lloje të ndryshme ushqimi; • <u>Ishit i detyruar</u> të hanit lloje të kufizuara të ushqimeve; • <u>Ishit i detyruar</u> të hanit çdo ditë të njëjtin ushqim; • <u>Ishit i detyruar</u> të hanit vetëm shumë pak lloje të ndryshme ushqimesh Kjo pyetje i referohet cilësisë së dietës dhe jo sasisë së ushqimit të konsumuar. Ajo nënkupton mungesën e parave/burimeve dhe jo rrethana të tjera (dmth. arsye shëndetsore ose fetare) si arsye për të kufizuar llojet e ushqimeve.

Q4. Keni qenë i detyruar të linit pa ngrënë ndonjë vakt, sepse nuk kishit paratë e mjaftueshme ose burimet për ta siguruar ushqimin?	Kjo pyetje kërkon përgjigje lidhur me përvojën e moskonsumimit apo të lënit pa ngrënë të një vakti kryesor (për shembull të mëngjesit, drekës ose darkës në varësi të normës së numrit dhe herëve që duhet ngrënë vakti në një kulturë) që normalisht duhet të hahej (sepse kanë munguar paratë e mjaftueshme ose burimet e tjera për të siguruar ushqimin). Kjo pyetje i referohet <u>sasisë së pamjaftueshme</u> të ushqimit.
Q5. Keni ngrënë më pak nga sa mendonit se duhet të hanit për shkak të mungesës së parave apo burimeve të tjera?	Kjo pyetje kërkon informacion lidhur me faktin që të intervistuarit hanë më pak nga sa mendojnë ata se duhet të hanë, edhe sikur të mos lënë asnjë vakt pa ngrënë (sepse familja nuk ka patur paratë apo burimet e tjera për të siguruar ushqimin). Përgjigja varet nga <u>mendimi i vetë të intervistuarit</u> në bazë të sasisë që ai mendon se duhet të konsumohet. Kjo pyetje i referohet <u>sasisë</u> së ushqimit të ngrënë dhe jo cilësisë së dietës. Kjo pyetje <i>nuk</i> u referohet dietave të veçanta për rënien në peshë apo për arsye shëndetësore ose fetare.
Q6. Familja juaj ka mbetur pa ushqim për shkak të mungesës së parave apo burimeve të tjera?	U referohet rasteve kur familja nuk ka pasur asgjë për të ngrënë sepse nuk i kanë patur paratë, burime të tjera, ose mënyra të tjera për ta siguruar atë.
Q7. Keni qenë i uritur por nuk keni ngrënë sepse nuk kishit paratë ose burime të tjera të mjaftueshme për të siguruar ushqimin?	Kjo pyetje lidhet me përvojën fizike të ndjesisë së urisë, dhe më veçanërisht, me të ndjerit i uritur dhe pamundësisë për të ngrënë mjaftueshëm (për shkak të mungesës së parave ose burimeve për të siguruar ushqimin e mjaftueshëm). Ajo nuk u referohet dietave të veçanta për të rënë në peshë, apo agjerimit për arsye shëndetësore ose fetare.
Q8. Keni ndjenjur pa ngrënë një ditë të tërë për shkak të mungesës së parave ose të burimeve të tjera?	Kjo pyetje lidhet me një sjellje specifike – të mos hash asgjë gjithë ditën (për shkak të mungesës së parave ose të burimeve të tjerave për të siguruar ushqim). Ajo nuk u referohet dietave të veçanta për të rënë në peshë, apo agjerimit për arsye shëndetësore ose fetare.
Kuptimi i frazave brenda fjalive kushtore	
12 muajt e fundit	Ekzistojnë mënyra të ndryshme për t’iu referuar një periudhe 12-mujore përpara momentit të intervistës, përfshirë edhe fjalën “vjet”. Duhet bërë kujdes që të zgjidhet fraza më e mirë në mënyrë që të mos ngatërrohet me koncepte të tjera të zakonshme të një periudhe 12-mujore të tilla si sezoni i bujqësisë ose një vit kalendarik fetar.
mungesa e parave ose e burimeve të tjerave për të siguruar ushqim	Përveç parave për të blerë ushqim, “burime të tjera” i referohet mungesës së mjeteve të tjera të zakonshme për të siguruar ushqimin, të tilla si prodhimi vetjak, bagëtia e imët për shitje apo për konsum vetjak, shkëmbimi, tregtia, peshkimi, gjuetia, ose vjelja